


ELI GANCE

Art



Njeriu dhe natyra - Agim Sulaj



AGIM SULAJ


Piktura e gjallë



NË UJËRAT E KALTRA TË JONIT REFLEKTOHET FYYRA E NJË VOGËLUSHI, PISHAT E GJELBRA TË LLOGARASË ME RRËNJËT E DALA MBI TOKË: JANË VEÇ NJË PJESË E PIKTURËS HIPER-REALISTE TË ARTISTIT AGIM SULAJ...

Mes pikturës e karikaturës, peneli i Agim Sulaj gjithnjë ngjiz imazhe hiper-realiste të cilat kur i sheh afrojnë tej mase me foton. Të ftojnë të hysh në një botë e cila ngjan oq ëndërrimtare, sa kushdo prej nesh gjen veten në një copëz prej tyre. Elegance sjell një intervistë me artistin shqiptar, i cili prej 3 vitesh ka fituar gjithashtu edhe çmimin e OKB-së për karikaturën "Qytetari dhe Politika", një vlerësim jo vetëm për talentin e Sulaj, por edhe tematikat e mprehta që ai zgjedh, shumica e të cilave gjenden sot në mediat më të njohura ndërkombëtare.

Sa jeni kthyer nga Festivali Ndërkombëtar i Arteve Vizive në Teheran, si ishte të jesh në juri dhe jo në garë?
Festivali Ndërkombëtar i Arteve Vizive "Fadri" i cili u zhvillua në Teheran ishte një eksperiencë e re për mua. Në këtë takim ndërkombëtar përfaqësohem me piktura, skulptura, qeramika, karikatura, kartonat, posteri, fotografia, ilustrimi dhe kalligrafia. Bëja pjesë në jurinë e seksionit Karikaturë dhe Kartona. Punimet i gjetëm të ekspozuara në sallat e



mrekullueshme të galerisë Saba, juria iraniane e kishte bërë seleksionimin dhe në përzgjedhëm bashkarisht vetëm fituesit. Irani mbahet si një nga vendet më të rëndësishme në botë për sa i përket artit të karikaturës e kartonave dhe i përzgjedhur në këtë juri është vërtet një lojë çmimi që i bëhet punës sime. Fituesit ishin iraniane, e midis tyre kishte fitues femra, gjë e cila pak vite më parë nuk bëhej fjalë në atë shtet. Artistet iraniane ishin shumë të kulturuar e plot talent dhe biseda e miqësia me ta

ishte të vlefshme. Pas jurisë e cila e mbaroi punën shpejt, kisha një takim në shtëpinë e humorit Iran Cartoon, që është pak a shumë qendra më e madhe iraniane e mbështetur nga shteti, e cila promovon artin e satirës e humorin në përgjithësi. (si dikur revista Hosteni në Tiranë dhe për fat të keq nuk ekziston më) ishte mjaft i këndshëm dhe takimi me studentët e artdashës në Muzeun e Artit Bashkohor në Teheran, që unë e quaja me të qeshur Tihran duke kujtuar me mall Tiranën...

Vitin 2013 e mbyllt me një çmim nga OKB-ja, pse ngjall interes karikatura juaj "Politika dhe Qytetari"?
Viti i shkruar u mbyll me një tjetër çmim, ai i Kombeve të Bashkuara në Nju York, një takim i përvitshëm i organizuar nga Ranan,Lurie, i cili vlerëson karikaturën më të mirë të publikuar në shtypin botëror gjatë 2013. Ky çmim është i treti që kam fituar: i pari në 2009, i dyti 2011 dhe vjet. Përsa i përket "Politikani dhe Qytetari", besoj se më mirë se unë mesazhin e përcjell vepra ime, pa fjalë. Ky çmim ndahet në Kombet e Bashkuara në prani të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon.

Kam parë disa piktura dhe karikatura tuaja, ku takohen dhe ndahen mes tyre?
Ecuria ime artistike mbështet në dy këmbë për "të ecur": njëra piktura dhe tjetra karikatura, ndryshojnë për nga mesazhi, por teknikisht janë njësoj. Edhe karikaturën e kuroj me detaje dhe psikologji, sikur të kisha përpara një tablo.



Hiper-realizmi në pikturën time ka lindur me mua. Gjithmonë kam pasur dëshirë t'i bëja objektet që pikturoja si të "gjalla"

Piktura juaj është hiper-realiste, si një ëndërr që kur zgjohesh e gjen të realizuar, pse kjo rrymë?
Hiper-realizmi në pikturën time besoj ka lindur me mua. Gjithmonë kam pasur dëshirë t'i bëja objektet që pikturoja si të "gjalla", plot detaje e gati t'i prekesh me dorë: e kisha këtë pasion dhe kur pikturoja shkëmbinjtë e Vlorës, besoj atje kam gjetur shkollën e parë të kësaj gjinie të artit, mjaft e lehtë për të bërë dhe jo të gjithë e kanë këtë dhuarë, pasi i jepet pak artistëve besoj...
Cilat janë teknikat që përdor në hiper-realizëm?
Teknika hiper-realiste nuk ka të bëjë me atë që përzien, ajo vjen instinktivisht, përqendrohet te rezultati. Mjetet e mia janë të thjeshta: penela të vegjël që mbushin me durim telajon centimetër për centimetër. Unë nuk e qelloj telajon, e përkedhel...!
Disa piktura tuaja lidhen me fëmijërimin apo vende në Shqipëri, i bëni personazhet dhe vendet të tilla ende për ju?
Shqipëria, e në veçanti qyteti i Vlorës e Tirana, ku

mund të përmbidhet e tërë jeta dhe pasuria ime artistike e fituar në atë vend, më kanë dhënë atë pigmentin e padukshëm të pasionit për vendin tim, mallin e nostalgjinë e cila shpesh është motivi i parë në tablotë e mia i referohen mbresave e kujtimeve të vendit që më dhuroi të parën gjë në botë, jetën e dashurinë për të. Te tablotë e mia do të gjejsh gurë e pisha, transparencë e fëmijë të shpenguar që kanë humbur sensin e kohës e lalen përherë në detin blu të imagjinatës sime.

Çfarë keni pikturuar fillimisht me hiper-realizëm kur ishit në Shqipëri?
Kam pikturuar pejsazhin e Vlorës: gurët, detin, fjetet e barit të vrullshme që mbushnin horizontin deri në pafundësi, shiun e rrëmbyer e diellin e Tiranës, rrugicat e Pazarit të Vjetër dhe hijet hijerëndë të pemëve nëpër kthesat e Llogarasë. Me orë e ditë kaloja nëpër pishat e Llogarasë duke gdhëndur me penel levozhgat e rrënjët e tyre.

Zakonisht format jo tradicionale nuk mirëpritën, jeni kritikuar apo mbështetur?
Jam mbështetur pak dhe kanë bërë mirë që nuk më kanë mbështetur sepse e kanë mprehur më mirë vrellin dhe inatin tim për të bërë pikërisht atë gjë që ishte e ndaluar, ose jashtë rregullave, po të isha pëlqyer atëherë, jam i sigurt se tani do të isha harruar...
Më shumë sesa piktura, karikatura ka një kontakt të drejtpërdrejtë me publikun, çfarë ju nxit të fokusoheni tek karikatura?
Karikatura është raporti që krijon artisti me jetën, ku nëpërmjet satirës kritikon defektet e jetës ku jetojmë, duke e bërë të dobishëm mesazhin për shoqërinë në përgjithësi. Metaforën e karikaturës nuk ma mësoi shkolla, as Akademia e Arteve. Gjithë eksperiencia dhe mënyra për t'i parë gjërat, ka filluar kur në diktaturën e proletariatit shikoja tabela të mëdha me punëtorë të qeshur dhe gra të lumtura, ndërsa në jetë shikoja punëtorë të vyshkur e gra të lodhura, bukuri e ndijësi të shpartalluara nga propaganda e jeta e vështirë. Miqtë e mi të atyre viteve nuk ishin njerëzit me kravata, edhe pse puna më lidhte me ta, por pleqtë e rrugicës ku





banoja, punëtorë bardhë e zi me cigare në buzë që të qeshnin e të prisnin në shtëpitë e tyre plot hare e aromë specash të skuqur.

Shumë prej tyre i shohim në media prestigjioze, si bashkëpunoni me to?

Bashkëpunimi me gazetatat në Itali apo jashtë, ka filluar më shumë prej tyre, pasi shpesh temat e mia përshtateshin me mesazhin ditor që trajtonin. Por, unë nuk jam karikaturist gazetash, shumë të tillë nëpër botë marrin rrogën dhe bëjnë një karikaturë në 10 minuta për të ilustruar këtë apo atë politikan. Vepra ime ka mesazh më të fortë, i cili mbetet në çdo kohë, nuk hidhet poshtë kur mbaron dita me gazetën. Botoj kryesisht kur duhet të dërgoj ndonjë karikaturë në konkurset e karikaturës si ai i Kombeve të Bashkuara, apo World Press Cartoon, ku në rregullorë është shkruar që vepra të jetë publikuar në shtypin periodik.

Karikatura është e "hidhur", por komunikon fort, ka ndikuar në zgjedhjen e tematikës? Temat e karikaturave të mia janë aktuale e të zbërthyera me imazhe domethënëse, të cilat japin përgjigje figurative të forta e bashkëkohëse. Për



këtë janë vlerësuar në të gjitha konkurrimet ndërkombëtare në të gjithë botën. Kjo më bën të lumtur sepse flas, besoj një gjuhë të thjeshtë, e të kuptueshme, atë të artit...

Prej vitesh jentoni në Itali, ju sillni bashkë me talentin, shkollën shqiptare, eksperiencat e penës tek Hosteni: identifikoheni si shqiptar, apo artisti është universal?

Në fillim i kisha këto meditime fillestare të atdheut, tani e ndjej veten qytetar i botës, i lindur në Shqipëri. Vendi im më dha hapat e parë, Italia hapat e dytë, e çdo vend ku fiton është një hap në të cilin shkel me punën tënde, ngre atë flamurin tënd, të fshehur brenda teje...!

Si ju duket arti shqiptar, një opinion për ekspozitat, punët a piktorët, a i ndiqni nga larg?

Nuk e kam ndjekur këto vite artin në Shqipëri, por ka artistë të zotë në atë vend, të cilëve tranzicioni i gjatë dhe i lodhshëm ju ka thyer gjenialitetin, dhe mundësinë për të shpërthyer...

A keni ndonjë projekt të ktheheni në Shqipëri? Për momentin nuk kam plane në Shqipëri, pasi kam projekte në Oksford dhe Luksemburg.